




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/OPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4601/13</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>31.12.2013</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3296/13, për z. Armend Krasniqi – Anëtar i Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, për arsye se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3296/13, për z. Armend Krasniqi – Anëtar i Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, dhe njëkohësisht avokat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Krasniqi, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë me ç ‘rast është diskutuar lidhur me dyshimin për situatën në të cilën ndodhet për të parandaluar situatën e mundshme e konfliktit të interesit.

z. Krasniqi ka konfirmuar se është Anëtar në Këshillin për Ndihmë Juridike Falas (KNJF) dhe njëkohësisht ushtron funksionin e avokatit, duke shtuar se në KNJF është dërguar sipas detyrës zyrtare nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

Pas kësaj Agjencia ka kontaktuar zyrtaret e Odes së Avokatëve të cilët kanë konfirmuar një gjë të tillë, duke shtuar se, përfaqësuesi në Këshillin për Ndihmë Juridike Falas duhet të jetë avokat.

Duke pasur parasysh këto të dhëna dhe duke u bazuar në nenin 16 (pika 1 dhe 2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik konstatojmë se në këtë situatë nuk ekziston konflikti i interesit.

Mirëpo, zyrtarit të lartë i bëhet me dije se është i obliguar të bëj deklarin rast për rast të interesave private në rastet kur mund të ketë rol përcaktues në një vendimmarrje konkrete si Anëtar i Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

Kjo është e rregulluar me nenin 13 (pika 1) ku thuhet se: “Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Rastet dhe mënyra për deklarin rast për rast të interesave private janë ta parapara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

